

VENDIM
Nr. 674, datë 22.11.2017

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, i shtohet fondi prej 14 978 760 (katërmëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekësh për organizimin e eventeve në kuadër të “Vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut”, për periudhën nëntor - dhjetor 2017.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama